



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË DHE
ADMINISTRIMIT TË PYJE/KULLOTAVE

NJOFTIM

Lënda : Publikimi i dhënies me qira të kullotave të lira.

Referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit nr.2 , datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari”, dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.11 datë 26.02.2026 “për Miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari për vitin 2026, të bëhet njoftimi i të gjithë fermerëve për aplikimin e kullotave Verore dhe Dimërore për kullotat e lira në territorin e Njesisë suaj Administrative.

Ju bëjmë me dije se kullotat e lira me destinacion **kullotje dhe kositje bari**, do të jepen **me afat 1 – 3 vjet, duke plotësuar dokumentacionin si më poshtë:**

1. Kërkesa me të dhënat e kërkuarit ,
 - gjeneralitetet,
 - vendbanimin ,
 - adresën e saktë ,
 - pikën e kontaktit,
 - ekonominë kullosore që kërkohet,
 - numrin e parcelës,
 - sipërfaqen e saj,
 - llojin e bagëtive,
 - numrin e krerëve që do të kullosin,
 - kohën e përdorimit të kullotës.
2. Çertifikata veterinare e cila lëshohet çdo vit nga shërbimi veterinar për gjëndjen epizotike të fermës së bagëtive.
3. Vërtetimi nga Njësia Administrative / Bashkia/ Kryetari i fshatit për vendëbanimin dhe nr. e krerëve
4. Lista e objekteve që kërkohen të ndërtohen në ndihmë të kullotjes si: stane , kasolle për blegtorët, mjedis për përpunimin e bulmetit etj.

KRYETARI
Nertil Bellaj